



BiEPAG

*Dokument konceptual, Maj 2023*

# ENERGJIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

**Autor: Dimitar Bechev\***

*\*Info për projektin kërkimor*

*Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' po kryen një studim gjithëpërfshirës për gjeopolitikën e tranzicionit të energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Studimi bazohet në analizë të dhënash, raste të detajuara studimore dhe në një sondazh të opinionit të realizuar gjatë periudhës mars-prill 2023 në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Shqipëri. Në këtë dokument konceptual jepen gjetjet paraprake nga hulumtimi dhe hedh bazat për zhvillimin e projektit në të ardhmen.*



---

# Abstrakt

---

**Sektori i energjisë në Ballkanin Perëndimor mbetet ende i varur nga qymyri dhe vuan nga korrupsioni dhe ryshfetet. BE ka tentuar të përkrahë reforma radikale duke nxitur dekarbonizimin dhe kalimin drejt energjisë së rinovueshme përmes politikës së kulaçit dhe kërbës. Megjithatë, aktorë të tretë, si Rusia, Kina dhe Turqia – së bashku me Shtetet e Bashkuara – i kanë hedhur rrënjët thellë në ekonominë e rajonit, ekonomi që bazohen në lëndë djegëse fosile, duke çimentuar kështu status quo-në dhe duke u kujdesur për interesat e veta në sektorin e energjisë.**

---

Për të kuptuar ndikimin e huaj mbi energjinë në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të marrin parasysh tendencat afatgjate dhe tiparet strukturore që e përcaktojnë këtë sektor. Ashtu si edhe degët e tjera të ekonomisë, energjia ndikohet nga historia dhe institucionet e shteteve politike. Duke qenë se ajo përshkon të gjithë ekonominë, shoqërinë, politikën dhe çështjet ndërkombëtare, energjia është padyshim pasqyrë e të gjithë rajonit. Fenomenet e nivelit makro dhe trashëgimitë institucionale si dhe proceset e tjera, si shpërbërja e Jugosllavisë dhe krijimi i shteteve nga kjo shpërbërje, tranzicioni postkomunist, politika e partive dhe zgjedhjet, privatizimi, qeverisja ekonomike, kapja e shtetit, integrimi në BE dhe evropianizimi, mosmarrëveshjet për sovranitetin, marrëdhëniet me aktorët jashtë BE-së dhe bashkëpunimi rajonal, ndër të tjera, të gjitha kanë një dimension të lidhur me energjinë.

Në këtë studim jepet një përmbledhje e shkurtër e situatës së energjisë në Ballkanin Perëndimor. Studimi ndahet në katër pjesë: (1) një përshkrim i shkurtër i historikut të zhvillimit të sektorit të energjisë nga mesi i shekullit të 20-të e deri më sot; (2) një panoramë e sektorit në ditët e sotme; (3) një analizë për ndikimin në rajon të tranzicionit të gjelbër të promovuar nga BE-ja; (4) dhe një diskutim për rolin që luajnë "fuqitë e jashtme", që janë Rusia, Kina dhe Turqia. Dokumenti mbyllet me disa përfundime për lidhjen e aktorëve të huaj me politikën e BE-së për nxitjen dhe ecurinë e mëtejshme të tranzicionit të gjelbër në vendet e Ballkanit Perëndimor që synojnë të anëtarësohen në BE.

---

# I. Pak histori

---

Sistemet energjetike të Ballkanit Perëndimor janë kryesisht funksion i industrializimit dhe urbanizimit të shpejtë që ndodhi gjatë periudhës jugosllave dhe regjimit komunist të Enver Hoxhës në Shqipëri. Pas vitit 1945, kërkesa për energji u rrit me një ritëm të qëndrueshëm. P.sh., mes viteve 1958 dhe 1979 konsumi u rrit me një normë vjetore prej 6.7%, krahasuar me mesatare prej 4.4% në botë.<sup>1</sup> Shteti investoi në objekte si termocentrale dhe hidrocentrale (TEC/HEC) si Kolubara në Serbi, Kosova A afër Prishtinës, REK Manastiri në Maqedoninë e Veriut, Komani në Lumin Drin në Shqipëri, rafineria NIS në Pançevë, Serbi, dhe gazsjellësi Adria që kalon nëpërmjet terminalit Omishalj në Kroaci. Ndryshe nga vendet e bllokut sovjetik, Shqipëria nuk kishte mundësi të siguronte burime kapitale, teknologji dhe ekspertizën e nevojshme për prodhimin e energjisë bërthamore. Jugosllavia bashkëpunoi me qeverinë amerikane dhe kompaninë energjetike Westinghouse për të ndërtuar impiantin e energjisë bërthamore (NEC) në Krshko. Kjo ishte një sipërmarrje e përbashkët e porositur në vitin 1983 nga republikat e atëhershme socialiste të Sllovenisë dhe Kroacisë.

---

## Edhe gjatë periudhës socialiste, ajo që më vonë do të bëhej Ballkani Perëndimor u pengua nga mungesa e investimeve të financuara nga vetë vendet.

---

Edhe gjatë periudhës socialiste, ajo që më vonë do të bëhej Ballkani Perëndimor u pengua nga mungesa e investimeve të financuara nga vetë vendet. Gazsjellësi Adria, për shembull, i përfunduar në 1974, u financua pjesërisht nga Kuvajti, Libia, Banka Botërore, Hungaria dhe Çekosllovakia. Rritja e varësisë nga huat e huaja për të bërë të mundur investimet në kapitalet e ngurta dhe në konsum u bë tipar strukturor i ekonomisë jugosllave që në vitet 1970 e më vonë, duke shkaktuar tensione të mëdha në federatë gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të 1980. Politika autarkike e Shqipërisë, veçanërisht pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën në mesin e viteve 1970, u përpoq të frenonte konsumin e brendshëm dhe të nxiste eksportet e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e saj si një burim i vlefshëm për valutë të huaj.

Një tjetër trashëgimi e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) është varësia nga furnizuesit e huaj për lëndët djegëse fosile, pra nafta e

---

<sup>1</sup> N. Bilcar, 'Problemet me furnizimin me energji në Jugosllavi, Revista 'Energija', 1983, <https://www.osti.gov/etdeweb/biblio/5948466>.

papërpunuar dhe gazi natyror. Deri në vitet 1980, RSFJ nxirrte rreth 1 miliard metër kub gaz (mld m<sup>3</sup>) nga fushat në Kroaci (si në tokë ashtu edhe në brigjet e Adriatikut), por kjo nuk përmbushte dot kërkesën në rritje që vinte nga industria dhe nga qytetet më të mëdha si Beogradi, Zagrebi, Sarajeva dhe Shkupi për ngrohje qendrore. Furnizuesi kryesor që u shfaq ishte Bashkimi Sovjetik, me gazin që pompohej në sistemin e shpërndarjes në Jugosllavi përmes Hungarisë. Nafta e papërpunuar vinte sërish kryesisht nga Bashkimi Sovjetik së bashku me Libinë dhe Irakun.

Shpërbërja e Jugosllavisë pati një efekt shkatërrues. Ndër problemet kryesore ishin dëmtimi i drejtpërdrejtë i infrastrukturës fizike; shkëputja e rrjetit elektrik nga pjesa tjetër e Evropës; ndikimi negativ i sanksioneve të OKB-së në atë që mbeti nga shpërbërja e Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi), ku përfshihej edhe ndalimi i eksporteve të naftës drejt këtij vendi; mosmarrëveshjet për pronësinë e objekteve të shpërndarjes (p.sh. në rastin e impiantit bërthamor të Krshkos, i cili shkaktoi konflikte të ndërlikuara ligjore mes Zagrebit dhe Lubjanës gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të 1990); investimet e rralla dhe të pamjaftueshme; dhe korrupsioni dhe klientelizmi, probleme që u përkeqësuan edhe më tej nga regjimet gjysmë-autoritare që lindën pas shpërbërjes. Ashtu si në vendet e tjera post-socialiste, varfëria energjetike u bë problem emergjent në të gjithë rajonin, shkaktuar edhe nga hiperinflacioni (në Serbi dhe Mal të Zi), nga lufta (në Bosnje/Kosovë), nga ndërprerja e lidhjeve tregtare (në Maqedoninë e Veriut) dhe nga rënia e qeverive (në Shqipëri) gjë që e përkeqësuan edhe më tej situatën.

Këto probleme të trashëguara janë ende barrë e madhe për ekonominë politike të energjisë në Ballkanin Perëndimor. Privatizimi në sektorin e naftës dhe gazit në vitet 1990 dhe 2000, nga i cili përfituan aktorët e brendshëm politikë, vazhdon të shkaktojë polemika në shumë vende. Qeveritë ngurrojnë të kryejnë reforma rrënjësore në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, sepse kjo mund të çojë në rritje të çmimeve dhe cenim të paqes sociale. Politikanët dhe klientela e partive i përdorin ndërmarrjet shtetërore për t'u pasuruar.<sup>2</sup> Rusia ka përdorur avantazhet e epokës sovjetike për të zgjeruar praninë e saj në sektorin e naftës dhe gazit. Edhe Kina ka instrumentalizuar kërkesën e madhe për investime të jashtme për të siguruar që kapacitetet e vjetra të vazhdojnë të prodhojnë energji elektrike të përballueshme me synimin për të avancuar me "diplomacinë e saj të borxhit" në Ballkanin Perëndimor.

---

2 Tena Prelec, 'Loja e tranzicionit: Këmbëngulja e elitave dhe praktikave nxjerrëse në sektorin e energjisë në shtetet pasardhëse të Jugosllavisë (vitet 1980-2010), Tezë doktrate, Universiteti i Suseksit,) 2020, <http://sro.sussex.ac.uk/id/eprint/94329/>.

## II. Struktura e sektorit të energjisë

Sektori i energjisë në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, dominohet ende nga ndërmarrjet publike në pronësi të shtetit. Edhe pse kjo është më se e vërtetë për energjinë elektrike dhe gazin natyror, është më pak e vërtetë në rastin e naftës, ku janë bërë privatizime të mëdha. Nga tre kompanitë kryesore të energjisë në rajon për sa i përket të ardhurave dhe kapitalizimit të tregut, dy janë në pronësi publike (Elektroprivreda Srbije ose EPS dhe JP Srbijagas), ndërsa kompania e tretë më e madhe është private, Naftna Industrija Srbije (NIS) – ish ndërmarrja shtetërore e naftës iu shit GazpromNeft të Ruisë në vitin 2008.

Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova përbëjnë një përjashtim të pjesshëm. Në vitin 2009 Podgorica i shiti 41% të aksioneve të EPCG-së, kompani e prodhimit të energjisë, kompanisë italiane të energjisë A2A, por që më vonë, në 2020, i riblenu këto aksione. Në vitin 2005, Maqedonia e Veriut e ndau ELEM-in në MEPSO (duke ruajtur kontrollin e rrjetit elektrik “Operatori i Sistemit të Transmisionit”, ose OST, për të përdorur nomenklaturën e BE-së) dhe ESM (prodhimi i energjisë) – si hapi i parë për ta shitur më pas MEPSO-n te EVN (Austri).<sup>3</sup> Në Kosovë në vitin 2013, ish konglomerati shtetëror KEK u nda në dy: KEK (miniera dhe gjenerimi i linjitetit) dhe KEDS/KESCO (shpërndarja dhe furnizimi). KEDS dhe KESCO më pas iu shitën konsorciumit turk Çalik-Limak.

Ndërmarrjet publike në pronësi të shtetit kryejnë funksione të rëndësishme sociale dhe politike. Nga njëra anë, ato janë një instrument për mbajtjen e çmimeve në nivel të përballeshëm për konsumatorët nëpërmjet formave të ndryshme të subvencioneve të energjisë dhe rifinancimeve. Nga ana tjetër, kompanitë e energjisë ofrojnë vende pune dhe burime për partitë politike dhe klientelën e tyre. Drejtori i përgjithshëm i Srbijagas, për shembull, është Dushan Bajatoviç, një anëtar i shquar dhe ish deputet i Partisë Socialiste të Serbisë (PSS). Drejtori i EPCG-së, Nikola Rovčanin, ishte më parë zëdhënës i Partisë Mali i Zi Demokratik, udhëhequr nga Aleksa Beçiç, që është një nga anëtarët më kryesore të koalicionit qeverisës që mori pushtetin pas zgjedhjeve të gushtit 2020. Kompanitë vjelin të ardhura nga qiratë, ndërkohë që humbjet dhe borxhet përfundimisht mbulohen nga buxheti i shtetit (ose i njësisë ekonomike në rastin e Bosnje dhe Hercegovinës) dhe nga taksapaguesit.

---

<sup>3</sup> Në vitin 2015, Elektromreže Srbije (EMS) bleu 10% të operatorit të shpërndarjes në Malin e Zi.

Dallimi ndërmjet ndërmarrjeve private dhe atyre shtetërore në praktikë shpesh nuk është i prerë si me thikë. Siç evidentohet edhe në hulumtimin e Tena Prelecit, si privatizimet ashtu edhe joprivatizimet në sektorët e energjisë të shteteve pasardhëse jugosllave kanë pasur shenjat dalluese të kapjes së shtetit<sup>4</sup>. Qoftë me transferimin e aseteve publike tek aktorë të brendshëm me lidhje politike me akses në subvencionet shtetërore dhe burime të tjera apo qoftë me krijimin e feudeve partiake brenda ndërmarrjeve shtetërore, modeli i marrëdhënies dhe i rregullave të pashkruara dhe supozimeve që janë në themel të tyre mbetet i njëjtë.<sup>5</sup>

**Uprkos sveprisutnoj neformalnosti i rentijerstvu, energetski sektor je prošao kroz određene reforme, koje su se ubrzale tokom 2010-ih. Nakon što su se pridružile Energetskoj zajednici, sve zemlje Zapadnog Balkana su prihvatile obavezu pridržavanja zakonodavstva EU koje je usmereno ka liberalizaciji.**

Pavarësisht këtij informaliteti të përhapur dhe manipulimeve, në sektorin e energjisë janë ndërmarrë disa reforma, të cilat u rritën me shpejtësi gjatë viteve 2010. Pas anëtarësimit në Komunitetin e Energjisë, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor pranojnë se duhet të respektojnë legjislacionin e BE-së që synon liberalizimin. Kompanitë kombëtare të energjisë elektrike dhe gazit të integruara vertikalisht<sup>6</sup> duhet të ndahen në subjekte të veçanta me fokus prodhimin dhe shpërndarjen/furnizimin. Kjo, së bashku me reformat e tjera, si krijimi i rregullatorëve të pavarur dhe shkëmbimeve të energjisë, synon tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) në sektorin e energjisë, forcimin e konkurrencës mes tregtarëve, duke bërë të mundur që bizneset dhe konsumatorët familjarë të kenë mundësi të zgjedhin mes ofruesve të ndryshëm dhe – me kalimin e kohës – të shkojnë drejt uljes së çmimeve.

4 Tena Prelec, 'Loja e tranzicionit: Këmbëngulja e elitave dhe praktikave nxjerrëse në sektorin e energjisë në shtetet pasardhëse të Jugosllavisë (vitet 1980-2010), Tezë doktorate, Universiteti i Suseksit,) 2020, <http://sro.sussex.ac.uk/id/eprint/94329/>. Shih edhe, Will Bartlett, 'Transformimi ekonomik dhe demokratizimi në Ballkan' në "Eksperimentimin me demokracinë", Routledge, 2000.

5 Vladimir Spasić, 'Kompanitë e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë në rajonin e Ballkanit -përgjegjësi ende e qeverive', Revista e Energjisë së Gjelbër në Ballkan, 2017, <https://balkangreenenergynews.com/power-production-and-distribution-companies-in-the-balkan-regiona-governments-still-in-charge/>.

6 Integrimi vertikal përfshin përqendrimin e prodhimit, importit, magazinimit, transmetimit, rrjeteve të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, gaz natyror ose naftë në duart e një subjekti të vetëm ekonomik, shpesh monopol kombëtar.

Maqedonia e Veriut dhe Kosova na tregojnë se si funksionon “ndarja”<sup>7</sup> në praktikë. Gjithsesi, në shumë raste, autoritetet kombëtare nuk kanë nxituar për të përafuar praktikën me acquis të BE-së. Serbia, për shembull, nuk e ka ndarë plotësisht EPS-në për të krijuar një OST plotësisht autonome (Elektromreže Srbije, EMS) dhe ende nuk e ka transferuar autoritetin nga Ministria e Energjisë te një ent rregullator<sup>8</sup>. Në Bosnje dhe Hercegovinë, ndarja e ndërmarrjes shtetërore është në një fazë të avancuar në Republika Srpska, por mbetet një punë në progres në Federatën e Bosnje-Hercegovinës, ndërkohë që mungon tërësisht në distriktin special të Brçkos, i cili përfiton nga një përjashtim.<sup>9</sup>

Ndarja në nënsektorin e gazit ka mbetur edhe më mbrapa. Kjo ndarje ka ecur më mirë në Maqedoninë e Veriut, me kompaninë ‘Burimet Kombëtare të Energjisë (NER) si operator të sistemit të transmetimit (OST)<sup>10</sup>. Në prill 2021, Serbia miratoi një plan për të ndarë Srbijagas dhe Yugorosgaz me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, ky plan nuk është zbatuar ende dhe Transportgas Srbija, operatori i rrjetit/OST, nuk është vënë ende plotësisht në punë<sup>11</sup>. Po ashtu, Gazprom zotëron shumicën e TEC Pançevo në Serbi (shih tabelën e mëposhtme). Ndërkohë në Bosnje dhe Hercegovinë ndarja është pjesërisht e përfunduar.

#### **Tabela I: Termocentralet me djegie gazi në Ballkanin Perëndimor**

Burimi: Gjurmuesi Botëror i Gazit [Harta e Gjurmuesit – Monitori Global i Energjisë](#)

Shteti	Termocentrali	Kapaciteti i instaluar, megavat (MW) (energji elektrike)	Teknologjia	Pronësia
Maqedoni e Veriut	TEC CHP-Shkup	230 MW	Cikël i kombinuar	Kompania e Gjenerimit të Territorit. 2 (TGC-2), Rusia 89.2%; Të tjerë: 10.8%
Serbia	TEC Pançevo	189 MW	Cikël i kombinuar	Gazprom 78%; Republika e Serbisë 22%
	TEC Zrenjanin	110 MW	Cikël i kombinuar	EPS
	TEC Novi Sad 250MW (2 njësi)	250 MW (2 njësi)	Turbinë me avull	EPS

7 Shkolla e Rregullores e Firences, “Ndarja në sektorët evropianë të energjisë elektrike dhe gazit” 2020, <https://fsr.eu.eu/unbundling-in-the-european-electricity-and-gas-sectors/>.

8 Komuniteti i Energjisë, Raporti i zbatimit për Serbinë, 2022, <https://www.energy-community.org/implementation/report/Serbia.html>

9 Komuniteti i Energjisë, Raporti i zbatimit për Bosnje Hercegovinën, <https://www.energy-community.org/implementation/report/Bosnia-Herzegovina.html>

10 Në vitin 2021, NER bleu aksionet e subjektit privat Makpetrol në Gazifikim Maqedoni (GAMA), duke krijuar një OST/OSSH të pavarur

11 Komuniteti i Energjisë 2023, <https://www.energy-community.org/implementation/Serbia/GAS.html#:~:texts=In%20April%202021%2C%20the%20Government.not%20being%20implemented%20as%20promised.>



Reformat institucionale dhe rregullatore janë me rëndësi të madhe për thithjen e investimeve dhe diversifikimin e furnizimit me energji. Kjo përfshin ngritjen e kapaciteteve të rinovueshme, të cilat mund të konkurrojnë me energjinë elektrike të prodhuar nga djegia e qymyrit, që ofrohet nga kompanitë aktuale. Nga ana tjetër, do të ishte e dobishme të hapeshin tregjet kombëtare për furnitorët dhe tregtarët e gazit natyror, përveç kompanive kombëtare, të cilat priren të kenë marrëdhënie afatgjata me Gazpromin e Ruisë.

### III. Varësia nga qymyri

Në përgjithësi, Ballkanit Perëndimor i mungojnë burimet vendase të energjisë. Përjashtim janë vetëm linjiti (qymyri i murrmë) si dhe hidrocentralet, të cilat janë me rëndësi jetike për prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe Mal të Zi.<sup>12</sup> Ka depozita të bollshme të qymyrit të shpërndara në rajon, ku madje Kosova pretendon se ka stokun e pestë më të madh në botë. Në vitin 2018, ishin 65 miniera që prodhonin 93 milionë tonë qymyr guri dhe linjit – që korrespondon me një të pestën e qymyrit të prodhuar në BE.<sup>13</sup> Rezervat e provuara të Serbisë korrespondojnë me 192 herë të konsumit të saj vjetor. Bosnja ka depozita me vlerë 264 vjet dhe Shqipëria një vlerë marramendëse prej 6000 vjetësh. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e naftës dhe gazit natyror që hyn në rajon importohet. Praktikisht nuk ka fare prodhim të naftës në vend dhe sasia e gazit natyror të nxjerrë është e ulët. P.sh., në vitin 2019 Serbia nxori vetëm 0,438 miliardë m<sup>3</sup>, që korrespondon me pak më shumë se një të pestën e kërkesës së saj vjetore.<sup>14</sup>

Nuk është habi që qymyri dhe hidrocentralet janë shtylla kurrizore e sistemeve energjetike në rajon. Kosova, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina janë në dhjetë vendet e para në botë për sa i përket raportit të përdorimit të qymyrit për prodhimin e energjisë elektrike: përkatësisht 94.9%, 70% dhe 67.7% (të dhënat për vitin 2020). Maqedonia e Veriut (51%) dhe Mali i Zi (41%) kanë përzjerje energjetike relativisht më të balancuara. Në vitin 2017, kapaciteti elektrik i instaluar 18 gigavat (GW) në rajon u nda pothuajse në mënyrë të barabartë midis TEC-eve që funksionojnë me qymyr dhe HEC-eve. Gjithsesi, aktualisht qymyri përbën 70% të bazës për prodhimin e energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor. Burimet e rinovueshme (diellore dhe era) mbeten shumë prapa dhe burimet të energjisë bërthamore nuk ekzistojnë fare nëse nuk marrim parasysh

<sup>12</sup> Dy hidrocentrale të mëdha, Peruçica (307 MW) dhe Piva (363 MW) sigurojnë deri në tre të katërtat e furnizimit me energji elektrike në vend.

<sup>13</sup> Pablo Ruiz Castillo, Hrvoje Medarac, Julian Somers dhe Giovanni Mandras, 'Tendencat e fundit në rajonet e qymyrit dhe torfës në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë', Bashkimi Evropian, 2021, <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC126154>.

<sup>14</sup> Të dhënat nga Komuniteti i Energjisë.

importet e energjisë elektrike të Ballkanit Perëndimor nga Hungaria, Rumania dhe Bullgaria fqinje.

**Tabela 2. Projektet e qymyrit në Ballkanin Perëndimor**

Burimi: Komuniteti i Energjisë

Shteti	Nr. i TEC-eve	Kapaciteti i instaluar, megavat (MW)	Përqindje në energjinë elektrike
Shqipëria	n/a	n/a	n/a
Bosnja dhe Hercegovina	5	2 GW	67.7%
Kosova	2	1.2 GW	94.9%
Mali i Zi	1	0.2 GW	41%
Maqedonia	2	0.8 GW	51%
Serbia	6	4.3 GW	70%

Sipas Komisionit Evropian, me qymyrin janë të lidhura rreth 138,000 vende pune në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (90,000 në industrinë minerare dhe 49,000 në TEC-et me bazë qymyri). Heqja graduale e qymyrit në përputhje me politikat e BE-së mund të sjellë humbjen e 0.4% të të gjitha vendeve të punës në Malin e Zi, 0.5% në Maqedoninë e Veriut, 0.6% në Serbi, 1.3% në Bosnje dhe Hercegovinë dhe 1.4% në Kosovë. Në dy rastet e fundit, qymyri përbën një përqindje akoma më të lartë të punësimit se në Poloni, ku pjesa përkatëse e fuqisë punëtore qëndron në 0.7%.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë treguar interes për TEC-et e rinj me qymyr për shkak të deficiteve të vazhdueshme të energjisë dhe vjetërsisë së termocentraleve ekzistuese, ku shumica e TEC-eve janë më të vjetër se 40 vjeçare. Në vitet 2010, pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor nisën projekte për të modernizuar TEC-et ekzistuese dhe për të ndërtuar të reja (shih kutizën informative më poshtë).

## BOSNJA DHE HERCEGOVINA

*Gjatë dekadës së fundit në Bosnje dhe Hercegovinë janë planifikuar disa termocentrale të reja, disa prej të cilave kanë përfunduar apo kanë filluar nga ndërtimi. Ka pasur përfshirje kryesisht të investitorëve kinezë, por të tjerë, në veçanti CEZ, ishin të përfshirë edhe në disa nga projektet para vitit 2010. Nëse këto projekte zbatohen, ato mund të dyfishojnë kapacitetin e prodhimit të linjtit në Bosnje:*

➤ TEC-i Stanari (300 MW): E ndërtuar pranë Banja Lukës, në Bosnje, ky TEC nisi prodhimin në vitin 2016. Investimi u financua nga një kredi nga Banka e Zhvillimit e Kinës dhe u ndërtua nga Korporata Elektrike Dongfang e Kinës.

> TEC-i Tuzlës 7(450 MW): Një projekt i përbashkët i financuar nga Exim Bank i Kinës në vitin 2017. Aktualisht, projekti është në pritje.

> TEC-i Banovići (350 MW): Në afërsi të Tuzlës, pranë minierës së linjtit me të njëjtin emër. Investimi ishte planifikuar të bëhej nga Korporata Elektrike Dongfang e Kinës dhe të financohej nga kreditë nga Banka Industriale dhe Tregtare e Kinës. Termocentrali nuk mori leje ndërtimi dhe i ka skaduar edhe leja mjedisore.

> TEC-i Ugljevik 3(600 MW): Ky ishte një zgjerim i TEC-it ekzistues, që më parë do të financohej nga një kredi bankare nga Kina, por që u anulua në vitin 2022. Para kësaj, në këtë TEC do të bëheshin investime nëpërmjet një partneriteti mes Republikës Srpska dhe biznesmenit rus Rashid Sardarov.<sup>15</sup>

> TEC-i Kakanj 8(350 MW): Ky TEC që ndodhet pranë Zenica-Doboj, në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës, ishte planifikuar më parë të financohej nga bankat kineze, ku investimi do të kryhej nga Kompania Kombëtare e Inxhinierisë Elektrike e Kinës. Projekti nuk duket se ka investitor aktualisht. Janë bërë të ditura edhe planet për Kakanj 9.

> TEC-i Gacko(350 MW): Ky projekt ndodhet në Republikën Srpska. Me tërheqjen e CEZ-it nga planet fillestare për zbatimin e projektit, u përfolën një sërë investitorësh të mundshëm kinezë në lidhje me të, së fundmi edhe një projekt i përbashkët me Korporatën e Inxhinierisë dhe Makinerive të Kinës.<sup>16</sup> Këto plane duket se janë braktisur dhe aktualisht nuk ka asnjë investitor të konfirmuar me interes për projektin.

## SERBIA

### ***Në Serbi janë planifikuar një sërë zgjerimesh të termocentraleve aktuale:***

> TEC-i Kostolac B3 (350 MW): Ky është një projekt i përbashkët i EPS-së me CMEC. Leja mjedisore e projektit u anulua nga gjykata, por u rilëshua nga autoritetet. EPS duket e përkushtuar ndaj projektit.

> TEC-i Kolubara B: Ky projekt fillimisht do të financohej nga BERZH, por kjo e fundit u tërhoq nga mbështetja. Pas kësaj, zbatimi ishte planifikuar në formën e një projekti të përbashkët mes EPS-së dhe PowerChina. Anulimi i projektit u njoftua nga Ministria e Minierave dhe Energjisë e Serbisë në vitin 2021, por nuk është e qartë nëse EPS ka hequr dorë nga projekti, pasi përmendet në planet strategjike të kompanisë për periudhën deri në vitin 2035.

> TEC-i Nikola Tesla B njësitë 3 dhe 4: Zgjerimi i termocentralit ekzistues do të ishte një investim i përbashkët i EPS-së dhe një investitori italian. Planet janë anuluar dhe lejet kanë skaduar.

## KOSOVA

---

> TEC-i Kosova C/Kosova e Re (500 MW): Ky ishte një projekt i përbashkët me ContourGlobal (Britani e Madhe) i bashkëfinancuar nga Banka Botërore. Projekti u braktis në vitin 2020 kur Banka Botërore tërhoqi mbështetjen. Një nga skenarët aktualë është përditësimi e njësive ekzistuese.

---

## MALI I ZI

---

> TEC-i Pljevlja II (300 MW): Ky është një zgjerim i TEC-it ekzistues, i cili përfundoi në vitin 1982. Projekti u anuluar pas disa vitesh mungese progresi me investitorët çekë dhe kinezë.

---

*Burimet: Komuniteti i Energjisë; Bankwatch; të dhënat nga SeeNews.*

Nën presionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe opozitës në nivel vendor dhe disa çështjeve gjyqësore, disa nga projektet në Tabelën 2 janë braktisur, përfshirë edhe Kosovën C, Plevlja II dhe potencialisht Tuzla 7. Përveç njësive të reja të linjitet të renditura më sipër, janë planifikuar, janë duke u zhvilluar ose kanë përfunduar edhe një sërë përmirësimesh të TEC-eve.

Pavarësisht politikave të BE-së për heqjen graduale të qymyrit dhe angazhimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor ndaj Agjendës së Gjellbër (më poshtë), kërkesa mbetet e fortë. Në vitin 2022, Serbia importoi 2.8 milionë ton qymyr (nga Bosnja, Mali i Zi, Bullgaria dhe Rumania, si dhe nga Indonezia përmes Kinës) dhe planifikon të sjellë 4.8 milionë tonë të tjerë në vitin 2023.<sup>15</sup> Në vitin 2022, Kosova importoi qymyr me vlerë 1.5 euro milion.

---

<sup>15</sup> Milica Rilak, 'Serbia planifikon të importojë 70% më shumë qymyr se në vitin 2022, por edhe të eksportojë 39% më shumë energji elektrike', *Biznis.rs*, <https://biznis.rs/vesti/srbija/srbija-planira-da-uveze-70-odsto-vise-uglja-i-20-odsto-vise-derivata-nego-u-2022-godini-ali-i-da-izveze-39-odsto-vise-struje/>.

## IV. Deficiti i energjisë

Investimet në qymyr janë nxitur nga deficiti i vazhdueshëm i energjisë nga i cili vuan përgjithësisht Ballkani Perëndimor. Në periudhat e pikut, rajoni importon energji elektrike nga fqinjët, p.sh., Rumania, Bullgaria dhe Hungaria si dhe nga Greqia, e cila është shfaqur si lider i burimeve të rinovueshme në rajonin më të gjerë të Evropës Juglindore.

### Kërkesa

Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, kërkesa për energji ka ndjekur trajektore të ndryshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, nga njëra anë, dhe në Serbi, Bosnjë dhe Mal të Zi nga ana tjetër. Në grupin e parë të vendeve, konsumi i energjisë elektrike është zgjeruar me shpejtësi – me një ritëm të pabesueshëm prej 267% në Shqipëri dhe me një të katërtën në Maqedoninë e Veriut mes viteve 1990 dhe 2020. Në Kosovë, ka pasur një zgjerim prej 90% mes viteve 2000 dhe 2010. Kjo u pasua nga një periudhë stabilizimi përpara një rritjeje tjetër prej 20% mes viteve 2018 dhe 2021. Ky ndryshim shpjegohet me rritjen e popullsisë në Kosovë dhe, në rastin e Shqipërisë, me rritjen e konsumit për frymë lidhur me ndryshimet ekonomike pas rënies së sistemit komunist.

Në grupin e dytë të vendeve, kërkesa ka rënë me 23.45% në Malin e Zi (krahasuar me 2005), me 11.59% në Bosnje dhe me 2.8% në Serbi. Tendenca të tilla si deindustrializimi, lëvizjet demografike dhe emigrimi kanë kompensuar rritjen e konsumit privat. Veçanërisht e dukshme ka qenë rënia e kërkesës industriale. Në Serbi, kërkesa nga industria u tkurr me 60% mes viteve 1990 dhe 1993. Në Bosnje, ajo u ul me 90% gjatë të njëjtës periudhë, që përkon me fillimin e luftës. Ndërkohë që në Serbi kërkesa për energji u rikuperua më pas me një ritëm të ngadaltë, në Bosnje kjo kërkesë ende nuk është rikuperuar. Kohët e fundit, në Mal të Zi fonderia më e madhe e aluminit nisi të pakësonte punën deri në mbylljen eventuale në vitin 2022.

### Oferta

Megjithatë, oferta në vend në mjaft raste nuk është në gjendje të kënaqë kërkesën. Kjo është më se e vërtetë gjatë sezonit kur përdoren pajisjet e ngrohjes (nëntor e dhjetor) në periudhën e ftohtë të dimrit. Çmimet me pakicë të subvencionuara, të cilat janë më të ulëta se çmimet e shitjes me shumicë, dhe mungesa në përgjithësi e ngrohjes qendrore jashtë qyteteve të mëdha rrit konsumin e energjisë elektrike nga familjet. Impiantet me qymyr nuk mund të

vazhdojnë për shkak të teknologjisë së tyre të vjetëruar dhe vështirësive të minierave. Ndërkohë, në vendet e varura nga hidrocentralet, si Shqipëria, niveli i ulët i prurjeve në diga gjatë verës përbëjnë një sfidë të madhe. Këtë situatë e përkeqësojnë thatësitat e shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Deficitet duhet të trajtohen duke importuar energji elektrike, qoftë nga brenda rajonit apo edhe nga vendet fqinje.

Megjithatë, në kushte më të buta, vendet si Serbia dhe Bosnja në fakt prodhojnë një suficit të energjisë elektrike, e cila eksportohet te fqinjët e tyre. Energjia e prodhuar nga qymyri është konkurruese për nga çmimi, sepse vendet në fjalë nuk tatojnë emetimet e karbonit, ndryshe nga vendet e BE-së.

## V. Kriza shumëplanëshe e viteve 2021-2022

Hendeku mes kërkesës dhe ofertës ishte veçanërisht i madh në periudhën nga fundi i vitit 2021 deri në vitin 2022. Çmimet me pakicë të energjisë elektrike arritën nivele që ishin dhjetë herë më të ulëta se çmimet rekord të shitjes me shumicë të energjisë elektrike (të lidhura me çmimin e gazit natyror në bursat evropiane).<sup>16</sup> Në dhjetor 2021, një avari në TENT TEC që i shërben Beogradit – i shkaktuar nga linjiti me cilësi të dobët nga investimi i pamjaftueshëm dhe menaxhimi i dobët i gropave – e detyroi EPS-në të importonte sasi të paprecedenta të qymyrit. Në korrik të vitit 2022, Ministria e Energjisë Zorana Mihajloviç deklaroi se për importimin e qymyrit dhe energjisë elektrike do të shpenzoheshin deri në 1 miliard euro deri në fund të vitit.<sup>17</sup> Kosova pati ndërprerje të furnizimit me energji në dimrin 2021-2022, ndërsa Maqedonia e Veriut u detyrua të rivinte në punë një TEC të vjetër në Negotinë, i cili punon me karburant të rëndë shumë ndotës. Hidrocentrali nuk mund të kompensonte dot deficitin. Rritje dramatike pësuan edhe çmimet e biomasës, një lëndë djegëse alternative që përdoret për ngrohjen e shtëpive dhe për gatim.

<sup>16</sup> Mirza Kushljugiç dhe Damir Miljeviç, 'Tranzicioni i energjisë në Ballkanin Perëndimor – si të ecet përpara', Revista e Energjisë së Gjelbër në Ballkan, 2022, <https://balkangreenenergynews.com/energy-transition-in-western-balkans-how-to-move-forward/>.

<sup>17</sup> Vladimir Spasiç, 'Serbia do të shpenzojë 1 miliardë euro për import energjie dhe qymyri deri në fund të vitit', Revista e Energjisë së Gjelbër në Ballkan, 2022, <https://balkangreenenergynews.com/serbia-to-spend-eur-1-billion-on-electricity-coal-imports-by-end-of-year/>.

Këto zhvillime ishin në proces e sipër që para fillimit të luftës në Ukrainë më 24 shkurtit 2022, e cila rriti çmimet në të gjithë Evropën dhe përforcoi ndjenjën e pasigurisë në Ballkanin Perëndimor. Në fund të korrikut 2022, çmimi i qymyrgurit arriti në 407.47 dollarë për ton, krahasuar me 165 dollarë që ishte në janar 2023. Deri në gusht, Kosova mendonte të vendoste racionim të energjisë.<sup>18</sup> Maqedonia e Veriut shpalli “gjendjen e jashtëzakonshme” një mujore, të cilën më vonë e zgjati deri në prill 2023. Po ashtu, kriza detyroi qeveritë e Ballkanit Perëndimor të vononin procesin e mospërdorimit të qymyrit. Maqedonia e Veriut e shtyu datën e synuar për këtë nga viti 2027 në 2030.

## VI. Tranzicioni i gjelbër

Në parim, vendet e Ballkanit Perëndimor janë zotuar të heqin dorë nga qymyri në përputhje me politikat e BE-së, Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe me angazhimet e tjera ndërkombëtare si Marrëveshja e Parisit për Klimën. Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut i janë bashkuar Aleancës “Fuqizimi përtej qymyrit” (Powering Past Coal) të nisur nga Kanadaja në Samitin COP23 (2017). Përveç kësaj, Traktati i Komunitetit të Energjisë ka dispozita për kufizimin e ndotjes nga termocentralet. Megjithatë, këto dispozita nuk përfshijnë heqjen graduale të qymyrit apo edhe reduktimin e prodhimit. Në vend të kësaj, ato i referohen modernizimit të kapaciteteve ekzistuese, p.sh., nëpërmjet instalimit të sistemeve të pastrimit për të reduktuar CO<sub>2</sub> (dyoksidin e karbonit) dhe SO<sub>2</sub> (dyoksidin e squfurit).

Kalimi nga qymyri te burimet e rinovueshme është pjesë e afrimit me BE-në. Në tetor 2020, liderët nga rajoni miratuan Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ata u angazhuan për harmonizimin e plotë me Ligjin e BE-së për Klimën me synim arritjen e neutralitetit të emetimeve deri në vitin 2050 dhe përmbushjen e objektivave të energjisë dhe klimës deri në vitin 2030. Po ashtu, Ballkani Perëndimor do t’i nënshtrohet të ashtuquajturit Mekanizëm i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM), i cili do të hyjë në fuqi në vitin 2026. Deklarata e Sofjes flet për vazhdimin e harmonizimit me Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE-së si dhe prezantimin e instrumenteve të tjera të përcaktimit të çmimeve në nivel rajonal për të nxitur dekarbonizimin. Deri tani, vetëm Mali i Zi, i cili e sheh veten si lider në rajon për sa i përket miratimit të standardeve të BE-së për energjinë dhe klimën, ka krijuar një skemë kombëtare të kufirit dhe tregtimit. Kjo mbulon TEC-in Plevlja, fonderinë e aluminit KAP (e


<sup>18</sup> Valentina Dimitrievska, ‘Shqipëria ndërhyr për të ndihmuar Kosovën të shmangë racionimin e energjisë elektrike’, bne IntelliNews, 2022, <https://intellinews.com/albania-steps-in-to-help-kosovo-avoid-electricity-rationing-253547/?source=kosovo>.

mbyllur në dhjetor 2021) dhe Uzinën e Çelikut Tosçelik. Megjithatë, rezultatet kanë qenë të ndryshme edhe për shkak të kontributit pa ambicie të përcaktuar në nivel kombëtar.<sup>19</sup>

Përtej synimeve të tilla, si përmirësimi i standardeve të emetimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë së shtëpive, për tranzicionin do të nevojitet zhvendosja e fokusit te burimet e rinovueshme. Në Strategjinë e Kosovës për Energjinë(2022)parashikohet instalimi irreth 1,600MW kapacitetit të rinovueshëm deri në vitin 2031, krahasuar me 900-1,200 MW të të gjithë kapacitetit në operim të ofruar aktualisht nga TEC-et. Në përgjithësi, pjesa e burimeve të rinovueshme është rritur në rajon, ndonëse në mënyrë të pabarabartë.

**Table 3: Energji elektrike e prodhuar nga burimet e energjisë së rinovueshme, 2010 dhe 2020 (% e konsumit bruto të energjisë elektrike**

Burimi: [Eurostat](#)



Kodet e shteteve: AL=Shqipëria; ME=Mali i Zi; TR=Turqia; RS=Serbia; MK=Maqedonia e Veriut; BA=Bosnja dhe Hercegovina; XK=Kosova\*

\* Ky përcaktim është pa paragjykimet për qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Kosovës për Pavarësinë.

**Shënim:** Të dhënat për Turqinë janë dhënë nga autoriteti kombëtar i statistikave dhe janë përgjegjësi e këtij autoriteti.

**Bosnja dhe Hercegovina:** të dhënat janë për vitin 2019 dhe jo 2020.

<sup>19</sup> NDC-të janë angazhime nga nënshkruesit e Marrëveshjes së Parisit për Klimën. Për më shumë informacion, shih Pippa Gallop, 'Përralla paralajmëruese e skemës së tregtimit të emetimeve në Malin e Zi', Bankwatch, 2022, <https://bankwatch.org/blog/the-cautionary-tale-of-montenegro-s-emission-trading-scheme>.



Pjesa më e madhe e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme vjen nga hidrocentralet. Kjo është problematike, pasi hidrocentralet, veçanërisht kur përdoren në projekte të vogla, shpesh kanë një ndikim negativ në mjedis.<sup>20</sup> Në vitet 2010 pati një shpërthim në numrin e sipërmarrjeve të tilla. Deri në vitin 2021, në Ballkanin Perëndimor u ndërtuan 490 hidrocentrale të reja me një kapacitet nën 10 MW, një rritje gati pesëfish në krahasim me vitin 2009.<sup>21</sup> Ky zgjerim u nxit nga tarifave preferenciale të blerjes të përcaktuara nga qeveritë dhe ligjvënësit.<sup>22</sup> Përveç kësaj, kompanitë e lidhura me politikën kanë përfituar nga skemat mbështetëse që synojnë sektorin hidrik.<sup>23</sup> Gjithsesi, ndonëse ato gjenerojnë të ardhura tërheqëse për aktorët e brendshëm, prodhimi nga këto sipërmarrje mbetet i pakonsiderueshëm.

Aktualisht, fokusi është te kalimin drejt projekteve të energjisë diellore dhe të erës, të cilat janë më miqësore me mjedisin, por edhe me kursim kostoje dhe nuk kërkojnë stimuj në formën e subvencioneve dhe tarifave preferenciale. Në prill të vitit 2021, Serbia miratoi një ligj të ri për burimet e rinovueshme, i cili ripërcakton tërësisht ndihmën shtetërore dhe kufizon gamën e tarifave për blerjet me çmime preferenciale.<sup>24</sup> Megjithatë, ndryshimet kanë hasur në kundërshtime të konsiderueshme nga ndërmarrjet publike (EPS dhe EMS), të cilat kanë përmendur stabilitetin e rrjetit si shqetësimin e tyre kryesor. Ndryshime të ngjashme kanë ndodhur edhe në Kosovë dhe në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës.

20 Tijana Dushej Ristev, 'Ekologjia, lumenjtë në Serbi dhe hidrocentralet e vogla: Cilat janë ndryshimet në Ligjin për Ruajtjen e Natyrës dhe ku është i ndaluar ndërtimi i HEC-ve', BBC News në serbisht, 2021, <https://www.bbc.com/serbian/lat/srbija-58025526>. See also, M. Mitić, 'Xhaketa dhuruar banorëve të Dadinac dhe aktivistëve në mbështetje të lumit Rupska,' Lajmet nga Jugu, 2023, <https://www.juznevesti.com/Drushtvo/Mestanima-Dadinca-i-aktivistima-donirane-jakne-kaopodraska-u-odbrani-Rupske-reke.sr.html>.

21 Pippa Gallop, 'Republika Srpska ua kalon fqinjëve të saj në ndalimin praktikisht të subvencioneve të hidrocentraleve për termocentralet e reja', Bankwatch, 2022, <https://bankwatch.org/blog/republika-srpska-moves-ahead-of-its-neighbours-in-virtually-halting-hydropower-subsidies-for-new-plants>.

22 Pippa Gallop, 'Republika Srpska ua kalon fqinjëve të saj në ndalimin praktikisht të subvencioneve të hidrocentraleve për termocentralet e reja', Bankwatch, 2022, <https://bankwatch.org/blog/republika-srpska-moves-ahead-of-its-neighbours-in-virtually-halting-hydropower-subsidies-for-new-plants>.

23 Vladimir Kostić dhe Dina Đorđević, 'Hidrocentralet e vogla: shteti dhe kompanitë e lidhura me shokun e ngushtë të Vuçiçit përfitojnë më shumë', Qendra për Gazetari Investigative e Serbisë, 2018, <https://www.cins.rs/en/small-hydroelectric-power-plants-the-state-and-companies-connected-to-vucics-best-man-profit-most/>.

24 Igor Đorđević, Teodora Vujoshević dhe Ivan Gazdić, 'Interes i lartë për energjitë e rinovueshme në Serbi - rregullore e re me pak fjalë', Revista e Energjisë së Gjelbër në Ballkan, 2021, <https://balkangreenenergynews.com/high-interest-in-renewables-in-serbia-new-regulation-in-a-nutshell/>.

Megjithatë, ndryshimi krijon edhe probleme të tjera, si garantimi i furnizimit bazë me energji (sasia minimale e energjisë elektrike që duhet të futet në rrjet në çdo kohë të dhënë, veçanërisht gjatë periudhave të pikut), e cila tani varet nga TEC-et me qymyr.<sup>25</sup> Kjo është arsyeja pse gazi natyror ka tërhequr një interes të madh si alternativë ndaj linjitet me një nivel më të ulët të emetimit të karbonit. Autoritetet e Maqedonisë së Veriut dhe kompania e energjisë elektrike ESM, për shembull, kanë plane të mbyllin njësinë 1 të TEC-it me qymyr në REK Manastir dhe në vitin 2024 ta zëvendësojnë atë me një njësi që gjeneron energji elektrike 250 MW dhe nxehtësi, sistem që funksionon me gaz.<sup>26</sup>

## VII. Ndikimi i huaj në sektorin e energjisë

Nga të gjithë aktorët jashtë BE-së të përfshirë në rajon, Rusia ka praninë më të madhe në sektorin energjetik të Ballkanit. Ky ndikim ka disa aspekte: (1) pjesa më e madhe e gazit natyror të konsumuar në Ballkanin Perëndimor – 2.7 mld m<sup>3</sup> në 2021 – furnizohet nga Rusia; (2) Subjektet ruse të kontrolluara nga shteti zotërojnë infrastrukturën më të rëndësishme të tranzitit dhe depozitimit të gazit, siç është Gazsjellësi TurkStream në Serbi dhe depozitat në Banatski Dvor; (3) Rusia zotëron ndërmarrjet kryesore të naftës, përfshirë kompaninë kombëtare të Serbisë NIS (Naftna Industrija Srbije), rafineritë, vend depozitat, rrjetet e shpërndarjes dhe shitjes me pakicë; dhe (4) Rusia furnizon tregjet vendase me naftë bruto.

### Gazi natyror në Ballkanin Perëndimor

Burimi: [Reuters](#); [ERC.org.mk](#); [Stat.gov.rs](#).

Shteti	Importet vjetore nga Rusia [2019]	Kërkesa për gaz
<b>Serbia</b>	2.1 mld m <sup>3</sup>	2.5 mld m <sup>3</sup>
<b>Bosnja</b>	0.236 mld m <sup>3</sup>	0.236 mld m <sup>3</sup>
<b>Maqedonia e Veriut</b>	0.296 mld m <sup>3</sup>	0.296 mld m <sup>3</sup>

<sup>25</sup> Në Serbi, debati rreth burimeve të rinovueshme është fokusuar kryesisht në sfidën e balancimit të rrjetit. Megjithatë, kur largimi gradual nga qymyri të bëhet një objektiv i sanksionuar në ligj, ka të ngjarë të shfaqen probleme me furnizimin bazë ashtu si në vendet anëtare të BE-së të Evropës Qendrore dhe Lindore.

<sup>26</sup> Revista e Energjisë e EJM, 'Maqedonia e Veriut: ESM do të zëvendësojë kapacitetin e gazit për njësinë 1 të TEC-it të Manastirit, 2021, <https://serbia-energy.eu/north-macedonia-esm-to-replace-gas-capacity-for-tpp-bitola-unit-1/>.

Varësia e Serbisë nga furnizimet me gaz rus është një trashëgimi e epokës jugosllave. Në vitin 1976, Petrol (Ljubljana) dhe INA (Zagreb) lidhën një kontratë me Bashkimin Sovjetik për 1.5 miliardë metër kub që do të importohet çdo vit nëpërmjet Austrisë duke përdorur një tubacion të ndërtuar nga kompania austriake OMV. Në vitin 1978, një tjetër sasi prej 1.65 mld m<sup>3</sup> u kontraktua për lëvizim përmes Hungarisë<sup>27</sup>. Deri në nisjen e Gazsjellësit TurkStream në vitin 2020, tubacioni hungarez mbeti kanali kryesor i importit për Gazprom-in, trashëgimtarin e Ministrisë Sovjetike të Gazit. Ndërkohë që Kroacia dhe Sllovenia post-jugosllave arritën ta diversifikonin furnizimin me gaz për vendet e tyre nëpërmjet kontratave me kompanitë perëndimore dhe nëpërmjet prodhimit në vend (Kroacia), Serbia ende tregton ekskluzivisht me Rusinë. E njëjta gjë vlen edhe për Bosnjën dhe Hercegovinën, duke qenë se Sarajeva merr gaz nga Serbia. Maqedonia e Veriut e merr gazin e saj përmes një lidhjeje me Bullgarinë që daton në vitet 1990.

Ashtu si me pjesët e tjera të Evropës Lindore, dominimi i Ruisë në sektorin e gazit në Ballkanin Perëndimor reflekton faktorë të tillë si pozicionin dominues të ndërmarrjeve shtetërore mbi tregjet kombëtare, lidhjet e kufizuara ndërkufitare për të lehtësuar diversifikimin e furnizimeve dhe lidhjet e ngushta të vendit me aktorët politikë që kanë ndikim në sektorin e energjisë.<sup>28</sup> Një faktor shtesë, specifik për Ballkanin Perëndimor, është madhësia e vogël e tregut rajonal. Së bashku, të gjashtë vendet konsumojnë midis 2.7-4 mld m<sup>3</sup> në vit, dy të tretat e të cilave shkojnë në Serbi. Kërkesa e kufizuar redukton stimujt për furnitorët e tjerë, përveç Gazprom-it, për të kërkuar akses dhe për të investuar në infrastrukturën e transmetimit. Kjo bën që qeveritë të marrin përgjegjësinë. Ndërkohë që këto të fundit përballen edhe me kufizime financiare, qeveria serbe mund të rikthehet tek lidhjet e saj të ngushta politike me Moskën.

Varësia e Ballkanit Perëndimor nga gazi rus ka qenë një çështje shqetësuese si për BE-në ashtu edhe për Shtetet e Bashkuara. Duke filluar nga ndërprerja e furnizimeve në janar 2009, politika e BE-së në rajon, si dhe në Evropën Lindore më gjerë, është fokusuar në ndërtimin e interkonjeksioneve dhe nxitjen për liberalizimin e tregjeve të brendshme, duke lejuar konkurrencën gaz-gaz. Ky është një objektivi që është mbështetur edhe nga qeveritë e njëpasnjëshme amerikane. Megjithatë, pak është arritur, me përjashtim të mundshëm të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) që kalon nga Shqipëria. Lufta në Ukrainë mund të japë një shtysë për diversifikimin. SHBA-ja është në mbështetje të një depozite gjigande pluskuese të magazinimit dhe rigazifikimit të gazit natyror të lëngshëm (LNG) në Aleksandroupolis, në Greqinë verilindore, e cila pritet të vihet në punë në fund të vitit 2023 ose në fillim të vitit të ardhshëm. Serbia mund të marrë gaz nga kjo depozitë sapo të përfundojë një interkonjeksion prej 1.8 mld

27 Per Högselius, *Gazi i Kuq: Rusia dhe Origjina e Varësisë së Energjisë Evropiane*, Palgrave Macmillan, 2012, fq. 171-2.

28 Për shembull, funksionari i Partisë Socialiste të Serbisë, Dushan Bajatović, i diskutuar më lart.

m<sup>3</sup> në vit me Bullgarinë, një projekt me interes të përbashkët i mbështetur nga BE. Janë hartuar plane për lidhjen e rrjeteve të Bosnjës dhe Kroacisë, të cilat do të hapin furnizime përmes terminalit Krk LNG (aktualisht i përmirësuar nga 2.9 mld m<sup>3</sup> në 6.1 mld m<sup>3</sup> në vit). BE po mbështet edhe një tubacion ndërlidhës midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, i cili mund të jetë mjaft i rëndësishëm për kalimin e planifikuar nga prodhimi i energjisë elektrike nga qymyri në gaz. E fundit, por jo për nga rëndësia, Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia dhe Bosnja kanë pasur prej kohësh plane për një të ashtuquajtur Gazsjellësi Jon-Adriatik që lidh TAP-in me portin e Splitit.

Investimet në infrastrukturën e re mbështeten në një skenar ku rritet kërkesa për gaz në rajon. Kjo mund të ndodhë si pjesë e një tranzicioni duke u larguar nga përdorimi i qymyrit. Sipas disa skenarëve, kapaciteti i energjisë elektrike me gaz në Ballkanin Perëndimor mund të përjetojë një rritje gati trefish, nga 779 MW në 2,442 MW. Nga ana tjetër, mund të ketë përfitime nëse familjet përdorin gaz për qëllime ngrohjeje dhe gatimi, gjë që do të reduktonte varësinë nga lëndët djegëse të ngurta dhe ndotëse dhe nga energjia elektrike e subvencionuar e prodhuar nga qymyri. Megjithatë, një skenar i tillë ka të metat e veta, pasi do të çonte në shkëputje të varësisë nga karburantet fosile dhe tregjet shumë të paqëndrueshme ndërkombëtare të gazit. Riorientim te përdorimi me shumicë i gazi mund të vonojë edhe më shumë nisjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe tranzicionin e gjelbër të Ballkanit Perëndimor, i cili tashmë po përparon ngadalë.<sup>29</sup>

Në vitet 2010, Kina nisi depërtimin e saj në sektorin energjetik të Ballkanit Perëndimor. Kreditë e saj të buta, thelbi i të ashtuquajturës Nisma "Një brez, një rrugë", u kanalizuan për të modernizuar dhe zgjeruar TEC-et me qymyr si në Kostolac (Serbi), Tuzla, Gacko dhe Stanari (Bosnje). Përgjithësisht, projektet e financuara nga Pekini zbatohen nga kontraktorë kinezë ku vetëm një pjesë e vogël e investimit shkon për ekonominë e shtetit pritës.<sup>30</sup> Në shtator 2021, Presidenti Kinez Xi Jinping u zotua në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së se Kina do të ndalonte financimin e projekteve me djegie qymyri jashtë vendit. Gjithsesi, në Ballkanin Perëndimor ka prova të kufizuara të këtij ndryshimi në politikën kineze.<sup>31</sup> Po ashtu, Nisma "Një brez, një rrugë" aktualisht po zvogëlohet, ndërkohë që Kina është në kërkim të projekteve më praktike dhe që kërkojnë më pak burime financiare por me potencial për të gjeneruar fitime më të mëdha. Në vazhdim, një ndryshim i tillë nënkupton tkurrje të financimeve për qymyrin dhe njëkohësisht rritje të projekteve të vogla për prodhimin e energjisë së rinovueshme, në përputhje me ndryshimet e kërkuara nga BE në strategjitë

29 Bankwatch, 'Ballkani Perëndimor: Zhvillimi i gazit me investime prej 3.5 miliardë eurosh paraqet rreziqe ekonomike dhe të sigurisë energjetike si dhe kërcënon tranzicionin e gjelbër', 2023, [https://bankwatch.org/press\\_release/western-balkans-e3-5-billion-gas-build-out-poses-economic-energy-security-risks-and-threatens-green-transition](https://bankwatch.org/press_release/western-balkans-e3-5-billion-gas-build-out-poses-economic-energy-security-risks-and-threatens-green-transition).

30 E njëjta gjë vlen në një farë mase edhe për Rusinë, pasi Gazprom sjell kontraktorët e vet dhe në rastin më të mirë përfshin firmat vendase si nënkontraktorë.

31 BBC News, 'Kina zotohet të ndalojë ndërtimin jashtë vendit të termocentraleve të reja të energjisë me djegie qymyri', 2021, <https://www.bbc.co.uk/news/world-asia-china-58647481>.

e saj dhe në legjislacionin kombëtar të energjisë. Krahasuar me Rusinë, Kina mund të sigurojë burime shumë më të mëdha financiare dhe teknologjike, duke u përshtatur edhe me ndryshimin e kushteve në vendet e synuara.

Portofoli i investimeve të Turqisë ka qenë më i larmishëm. Çalık-Limak zotëron Kompaninë Kosovare për Distribim me Energji Elektrike sh.a (KEDS). Firmat turke kanë investuar edhe në projekte të energjisë së rinovueshme si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut. Grupi energjetik Guris ka drejtuar përpjekjet për të ndërtuar një park me turbina ere në Kitka, i cili u financuar pjesërisht nga BERZH. Fortim Energy po ndërton një impiant të energjisë diellore pranë minierës së qymyrit Oslomej në Maqedoninë e Veriut, në partneritet me Solarpro Holding të Bullgarisë. Duke qenë se Turqia po përjeton një bum në kapacitetet e reja të prodhimit të energjisë së rinovueshme, ka të ngjarë që ajo të kanalizojë më shumë investime në Ballkanin Perëndimor.

Ajo që kanë të përbashkët Rusia, Kina dhe Turqia është se investimet e tyre priren të jenë shumë të orientuara politikisht. Investitorët e huaj mbështeten nga qeveritë e tyre, të cilat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me homologët e tyre të Ballkanit Perëndimor. Shpesh lidhjet bëhen mes udhëheqësve politikë, të cilët janë garantuesit kryesorë për investitorët e jashtëm dhe veprojnë si zëvendësues të shtetit të së drejtës. Marrëdhënie të tilla janë të konsoliduara në një sistem ryshfetesh, subvencionesh dhe formash të tjera të pagesave nën dorë si për elitat politike ashtu edhe për subjektet e biznesit në fjalë. Në këtë kuptim, ndikimi i huaj në sektorin energjetik të Ballkanit Perëndimor është njëkohësisht funksion dhe faktor kontribues në kapjen e shtetit/politikës që përcakton ekonominë politike të rajonit.

Politikat dhe preferencat e Ruisë dhe Kinës janë në kundërshtim me tranzicionin e gjelbër të drejtuar nga BE. Rusia është e interesuar të ruajë status quo-në dhe të pengojë zgjerimin e furnitorëve konkurrentë të gazit në rajon. Kjo në mënyrë të tërthortë çimenton rolin udhëheqës të qymyrit në sistemet kombëtare të energjisë në vendet kryesore si Serbia dhe Bosnja. Për shkak të mungesës së tij dhe kostos relativisht të lartë, gazi nuk mund të shërbejë si lëndë djegëse e përkohshme për kalimin në një ekonomi me reduktim karboni. Kjo do të thotë se vendet e Ballkanit do të duhet të bëjnë një hap të drejtpërdrejtë për të kaluar nga qymyri te burimet e rinovueshme dhe jo të mbështeten te gazi si urë kalimi, siç është përpjekur të bëjë Maqedonia e Veriut. Ndikimi negativ i Kinës është edhe më i lehtë për t'u përcaktuar për shkak të mbështetjes financiare që ajo ka dhënë për TEC-et që përdorin linjtin si lëndë djegëse. Një financim i tillë zbut presionin e BE-së mbi qeveritë për heqjen graduale të qymyrit në përputhje me angazhimet e tyre sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Shfaqja e investitorëve të mundshëm kinezë nga viti 2010 e në vazhdim solli vonesa në vendimet për rrugët alternative për zhvillimin e sektorit të energjisë. Investimet nuk u materializuan

në një nivel të konsiderueshme dhe në fakt Kina tani po i zgjedh projektet e Nismës “Një brez, një rrugë” me më shumë maturi krahasuar me angazhimin e saj fillestar me rajonin. Megjithatë, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë humbur një dekadë në këtë periudhë, sepse politikanët kanë vënë bast që Pekini do të ringjallë impiantet që djegin qymyr.

## VIII. Përfundime

Sektori energjetik në Ballkanin Perëndimor është kryesisht produkt i varësive nga kushtet lokale dhe rrugëve të ndjekura, nga trashëgimia e modernizimit të epokës socialiste deri te përvoja e transformimit postkomunist dhe shpërbërja e shtetit/shtetformimi mes konflikteve në vitet 1990. Aktorët vendorë si partitë politike, udhëheqësit, lobet e biznesit dhe grupet kryesore të shoqërisë kanë luajtur një rol themelor në formësimin e sektorit. Dhe në pjesën më të madhe, ata mbeten në favor të status quo-së, e cila përqendrohet, para së gjithash, te lëndët djegëse fosile dhe qymyri linjiti si dhe te kompanitë e mëdha të mbështetura nga shteti që ofrojnë pagesa të fshehta për grupet e veçanta të interesit dhe që sigurojnë stabilitetin social afatshkurtër.

Në të njëjtën kohë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ekspozuar ndaj ndikimit të huaj, i cili është rritur ndjeshëm në këto 15 vitet e fundit. Ka disa forma se si ndikimit i huaj përshkon sektorin energjetik të rajonit.

Së pari, kompanitë e huaja shtetërore ose kompanitë me mbështetje shtetërore kontrollojnë asetet kritike në nën-sektorët e gazit natyror, naftës dhe energjisë elektrike. Serbia, ku firmat ruse si Gazpromneft, Gazprom dhe Lukoil luajnë një rol të rëndësishëm, është shembulli kryesor, ndonëse vështirë se është për t'u veçuar. Edhe në vendet me prirje perëndimore si Maqedonia e Veriut, Rusia mbetet një aktor i rëndësishëm në shërbimet publike, siç është termocentrali i gazit me cikël të kombinuar pranë Shkupit. Në të njëjtën mënyrë, dhe qeveritë dhe kompanitë në BE dhe SHBA kanë qenë në pararojë të zhvillimit të infrastrukturës së tranzitit të gazit, siç është gazsjellësi Trans Adriatik që kalon nëpër Shqipëri.<sup>32</sup>

Së dyti, financimet e huaja (ndihma e drejtpërdrejtë, kredi, investimet e huaja të drejtpërdrejta) janë me rëndësi tejet të madhe për zhvillimin e infrastrukturës dhe të kapaciteteve gjeneruese. Si Rusia ashtu edhe BE-ja kanë investuar për kalimin të përdorimi i gazit me synim përmbushjen e objektivave të tyre: mbylljen e tregjeve rajonale ose liberalizimin e tregut dhe promovimin e diversifikimit të

<sup>32</sup> SNAM, i kontrolluar nga shteti italian, zotëron 20% në TAP, ashtu si edhe SOCAR, kompania e gazit e Azerbajxhanit dhe kompania shumëkombëshe britanike BP e kuotuar në bursë.

furnizimeve. Kina, por edhe ShBA<sup>33</sup>, janë përfshirë në përdorimin e qymyrit, p.sh., duke dhënë kredi të buta dhe duke bërë investime për rehabilitimin e TEC-eve të vjetra dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja. Edhe sektori i burimeve të rinovueshme po tërheq më shumë interes, ku kompanitë e BE-së dhe ato turke po sjellin investime në Ballkanin Perëndimor dhe ku Kina po ofron teknologjinë kyçe (p.sh. panele diellore dhe turbina me erë).

Të marra së bashku, marrja e pronësisë nga të huajt dhe flukset financiare nga jashtë ndikojnë shumë në politikën dhe planifikimin strategjik. Siç tregohet edhe nga interesi i Kinës për TEC-et në Serbi, Bosnjë dhe Mal të Zi, perspektiva e kredive të buta për të mbështetur industrinë vendase me interes për elitat politike ka sjellë vonesa në marrjen e vendimeve kryesore që lidhen me trajektoren e ardhshme të sektorit.


Së treti, aktorët e huaj ndihmojnë në krijimin e mjedisit rregullator. BE i ka nxitur vazhdimisht vendet kandidatë në Ballkanin Perëndimor që të harmonizojnë legjislacionin e tyre me acquis për energjinë dhe klimën. Në krahun e kundërt, Rusia ka përfituar nga mungesa e progresit të Serbisë dhe Bosnjës në përafrimin e legjislacionit vendas me rregullat e BE-së duke konsoliduar pozicionin e saj dominues në treg e duke shtuar kontrollin mbi infrastrukturën tranzite me monopolin e saj aktual si furnitor i vetëm në treg. Në të njëjtën linjë, investimet në qymyr nga Kina u bënë të mundura nga fakti se Ballkani Perëndimor ende nuk ka zbatuar skemat e çmimit të karbonit që respektojnë kuadrin e BE-së. Kjo reduktoi stimujt e nevojshëm që vendimmarrësit të mundësonin harmonizimin e kuadrit të tyre ligjor, pavarësisht qëllimit të shpallur haptazi për t'u anëtarësuar në BE.

Së fundi, fokusi i vendeve të Ballkanit Perëndimor tek lëndët djegëse fosile krijon varësi nga importet. Kjo është më e dukshme me gazin natyror për shkak të veçorive të tregut dhe mbështetjes në interkoneksionet fizike dhe kontratat afatgjata. Por kjo gjë vlen edhe për naftën bruto dhe gjithnjë e më shumë për qymyrin, pasi minierat vendase nuk arrijnë të përmbushin kërkesën maksimale. Kjo është arsyeja pse duhet një strategji që i jep prioritet energjisë së rinovueshme, një sektor ku Ballkani Perëndimor ka një avantazh për shkak të burimeve të tij vendore. Kjo strategji ofron një rrugë më të mirë drejt së ardhmes si për sigurinë e furnizimit ashtu edhe për qëndrueshmërinë mjedisore.


Nuk ka dyshim se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor qëndron në energjinë e rinovueshme. Megjithatë, efekti i kombinuar i varësisë për një kohë shumë të gjatë nga lëndët djegëse fosile, institucionet e dobëta dhe ndikimi i huaj ka bërë që rajoni të jetë në ngërç jo vetëm për Evropën në tërësi, por edhe në krahasim me pjesët e tjera të Evropës Juglindore. Për të mbyllur këtë hendek dhe për të përshpejtuar tranzicionin e gjelbër, BE duhet të punojë më ngushtë me aktorët kryesorë vendorë, si me qeverinë, përfaqësuesit e biznesit, shoqërinë civile dhe komunitetin e ekspertëve.

<sup>33</sup> Projekti i anuluar nga ContourGlobal në Kosovë është një shembull i projekteve amerikane të qymyrit. Kompania ka investuar në vende të tjera të rajonit, si në Bullgari. SHBA mbetet vendi i tretë më i madh në botë për sa i përket kapacitetit me bazë qymyri, pas Kinës dhe Indisë.


**Kombinimi i lëndëve djegëse primare në Shqipëri  
në vitin 2020 (në ktoe)**



**Kombinimi i lëndëve djegëse primare  
në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2020 (në ktoe)**




**Kombinimi i lëndëve djegëse primare në Kosovë\*  
në vitin 2020 (në ktoe)**







**Kombinimi i lëndëve djegëse primare në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 (në ktoe)**



**Kombinimi i lëndëve djegëse primare në Malin e Zi në vitin 2020 (në ktoe)**




**Kombinimi i lëndëve djegëse primare në Serbi në vitin 2020 (në ktoe)**



### Raporti i energjisë nga burimet e rinovueshme, 2010 dhe 2020

(% e konsumit përfundimtar bruto të energjisë)




Burimi: Eurostat, Komisioni Evropian

Shteti	2010	2020
BE	14.4	22.1
Shqipëria	31.9	45.0
Mali i Zi	40.6	43.8
Serbia	19.8	26.0
Maqedonia e Veriut	16.5	19.2
Bosnja dhe Hercegovina (¹)	18.7	37.6
Kosova*	18.2	24.4

### Varësia nga energjia, 2010 dhe 2020

(% e importit neto në energjinë bruto të disponueshme, bazuar në toe)



Burimi: Eurostat, Komisioni Evropianw

<b>Shteti</b>	<b>2010</b>	<b>2020</b>
<b>Turqia</b>	70.7	70.6
<b>Maqedonia e Veriut</b>	44.0	63.3
<b>Shqipëria</b>	28.9	35.9
<b>Serbia</b>	33.5	29.8
<b>Mali i Zi</b>	26.4	27.4
<b>Kosova*</b>	24.6	29.5
<b>Bosnja dhe Hercegovina (1)</b>		25.4

## Rreth nesh

---

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Kordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihić, Richard Grieveson, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent kordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

**<https://biepag.eu>**

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Drejtore Programi

[milena.stefanovic@balkanfund.org](mailto:milena.stefanovic@balkanfund.org)

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes

organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

**[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)**

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive

[aleksandra.tomanic@balkanfund.org](mailto:aleksandra.tomanic@balkanfund.org)

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

**<http://csees.uni-graz.at/>**

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER

Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore

[florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)

Ky studim u mbështet nga Fondacioni Evropian për Klimën. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë studim i përket autorit. Fondacioni Evropian i Klimës nuk mund të mbajë përgjegjësi për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacionit që përmban ose shprehet në këtë studim.

©Fondi Evropian për Ballkanin 2020. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

